




IKTK

INSTITUTI KOMBËTAR I
TRASHËGIMISË KULTURORE

**DITARI
MUJOR**

GUSHT
2025

GUSHT
2025

DITARI MUJOR



**Verifikim i gjendjes
së konservimit të
Mozaikut të Kishës
Paleokristiane (shek. VI)**

Në kuadër të hartimit të projektit për ndërhyrjen konservuese/restauruese në Mozaikun e Kishës Paleokristiane (shek. VI) në Parkun Arkeologjik të Antigonesë, specialistët e IKTK-së, në bashkëpunim me specialistët e parkut (DRTK Gjirokastrë), kryen një verifikim të gjendjes së konservimit të mozaikut.





Ky hap është pjesë e procesit për mbrojtjen dhe ruajtjen e një prej dëshmimeve më të çmuara të trashëgimisë sonë kulturore.





Inspektim në terren në kuadër të verifikimit të interesit kulturor

Specialistët e IKTK-së, në bashkëpunim me DRTK Gjirokastrë, zhvilluan një inspektim në terren në kuadër të verifikimit të interesit kulturor për 'Qytetin antik të Rabies', me vendndodhje në fshatin Rabie të Bashkisë Memaliaj.



Ky qytet antik, i datuar në shekullin IV para Krishtit, i njohur si një fortifikim mbrojtës i kufijve juglindorë të Bylinëve, ka një rëndësi të veçantë për arkeologjinë dhe historinë e vendit tonë.

Gjatë inspektimit në terren u realizua:

- Vëzhgimi i sipërfaqes së kodrës ku shtrihet siti;
- Dokumentimi fotografik i mureve rrethuese dhe strukturave të dukshme;
- Marrja e pikave koordinative për përcaktimin e shtrirjes së qytetit;
- Vëzhgim i territorit përreth dhe vlerësim i zonës mbrojtëse.



DITARI MUJOR


Zonifikimi Arkeologjik në Bushat, Shkodër

Në kuadër të procesit të punës për hartimin e Zonifikimit Arkeologjik dhe Rregullores së administrimit për zonën arkeologjike “A” Bushat, specialistët e IKTK-së në bashkëpunim me specialistët e DRTK Shkodër kryen inspektimin në terren, i cili konsistoi në:

- Dokumentimin fotografik të sitit me dron;
- Hartografinë përmes marrjes së koordinatave të sitit arkeologjik në terren;
- Pozicionimin në hartë të strukturave arkeologjike të zbuluara dhe zonave me potencial arkeologjik.



Me anë të këtij procesi, IKTK synon mbrojtjen e një siti me interes të lartë arkeologjik dhe shkencor për vlerat që mbart, si dhe ruajtjen e trashëgimisë arkeologjike si një zonë me potencial për gërmime dhe kërkime të mëtejshme, në përputhje me kuadrin ligjor për mbrojtjen e zonave arkeologjike.



Ruajtja, dokumentimi dhe menaxhimi i trashëgimisë arkeologjike mbeten PRIORITETI ynë!



Në kuadër të projektit kërkimor-shkencor “Apolonia e Ilirisë”

I bashkëdrejtuar nga profesorët Belisa Muka dhe François Quantin, vijon me përkushtim bashkëpunimi ndërinstitucional ndërmjet Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Shkencave e Shqipërisë), UMR 8546 – AOrOc Paris, Shkollës Franceze të Athinës (EfA), Shkollës Franceze të Romës (EfR), Departamentit të Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore (Universiteti i Tiranës), IKTK-së dhe Parkut Arkeologjik Kombëtar Apolonia (nën varësinë e MEKI-t).



Programi i vitit 2025 është përqendruar në tri zona kryesore të sitit arkeologjik:

- Sektori i termeve të periudhës romake
- Porta verilindore
- Linja e fortifikimit



Paralelisht me gërmimet, vijon puna e studimit të materialit arkeologjik dhe formimi i studentëve shqiptarë e francezë, përmes trajnimeve mbi metodologjitë bashkëkohore të dokumentimit, si dhe analizës së teknikës, stilit dhe ikonografisë së skulpturave antike.



Ekspeditë informative në Kishën e Manastirit të Shën Marenës.

IKTK, në bashkëpunim me DRTK Korçë dhe Bashkinë Pogradec (Sektori i Turizmit dhe Trashëgimisë), zhvilloi një ekspeditë informative për të verifikuar gjendjen e ruajtjes së pikturës murale dhe tavanit të dekoruar. Gjatë inspektimit u kryen:

- Matje të sipërfaqes së pikturës
- Skica dhe fotografi dokumentuese
- Evidentimi i problematikave



Ekspeditë informative në Kishën e Manastirit të Shën Marenës.


Në kuadër të hartimit të projektit për konservimin dhe restaurimin e pikturës murale dhe tavanit të dekoruar në Kishën e Manastirit të Shën Marenës, sot u zhvillua një ekspeditë informative për të verifikuar gjendjen e ruajtjes së tyre.

Kisha e Shën Marenës ndodhet në fshatin Llëngë, në zemër të krahinës së Mokrrës, një zonë e thellë malore me histori e traditë të pasur. Piktura murale e këtij monumenti daton në vitin 1754 dhe i atribuohet mjeshtrit të madh të ikonografisë shqiptare, Kostandin Shpataraku.



Mozaikët e Butrintit!

Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit në zbatim të programit të monitorimit dhe ruajtjes së mozaikëve në Parkun Kombëtar të Butrintit nisi këtë sezon me hapjen e mozaikut të Termeve romake pranë Teatrit dhe të Kthinës veriore të Gjimnazit.



Mozaiku në Termen romake pranë Teatrit paraqet një dizajn gjeometrik bardh e zi, të rrethuar me një kornizë të kuqe.

Mozaiku në Kthinën veriore të Gjimnazit paraqet një dizajn me nyjet e Solomonit, një simbol antik që përfaqëson lidhjen midis tokës dhe parajsës.

